

VENDIM
Nr. 471, datë 30.5.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
TË SIPËRFAQES 1827 M², PRONË SHTETËRORE, PËR NDËRTIMIN E GODINËS SË
PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të sipërfaqes prej 1827 (një mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) m², e ndodhur në zonën kadastrale 8591, me nr. pasurie 4/210, indeks harte SH-Q-5, Sh-P-5, pronë shtetërore, sipas planimetrisë dhe planvendosjes bashkëlidhur Prokurorisë së Përgjithshme për ndërtimin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Prokurorisë së Përgjithshme i ndalohet tjetërsimi apo dhënia në përdorim e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për qëllime të tjera, të ndryshme nga ndërtimi i godinës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Prokuroria e Përgjithshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha